



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prillog 30.12.2011

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendnost
01-013/	2344	-	-



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 pika a.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35 paragrafi 2 pika a) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2011 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01-013/838 PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË REGJISTRIMIT NË REGJISTRAT KADASTRAL TË PRONAVE TË PA LUAJTSHME TË FITUARA NGA ISH NDËRMARRJET SHOQËRORE

Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, SHFUQIZON Vendimin për pezullimin e përkohshëm të regjistrimit në regjistrat kadastral të pronave të pa luajtshme të fituara nga ish ndërmarrjet shoqërore numër 01-013/838 të datës 11.03.2008.

Neni 2

Shfuqizimi i Vendimit për pezullimin e përkohshëm të regjistrimit në regjistrat kadastral të pronave të pa luajtshme të fituara nga ish ndërmarrjet shoqërore bëhet në bazë të kërkesave të mëdha të subjekteve të ndryshme në zgjidhjen e kërkesave të tyre pronësoro – juridike dhe krijimit të kushteve më të favorshme për regjistrimin e pronave të pa luajtshme pas arritjes së marrëveshjes për kthimin e dokumentacionit kadastral.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

01.Nr. _____
Viti, 28.12.2011



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi